



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 675/Prot  
5

Tiranë, më 29 07.2016

VENDIM

Nr. 48, datë 29.07.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.148, datë 13.06.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 21.06.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ, pranë kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri nga kontrolluesi Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë, gjatë kryerjes së veprimtarisë të tij në fushën e arsimit.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.148, datë 13.06.2016 të Komisionerit "Për kryerjen e hetimit administrativ" që do të ushtrohej pranë këtij kontrolluesi.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi nuk ka kryer "Njoftimin" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21-22 të ligjit.
2. Kontrolluesi aplikon për disa punëmarrës e D.A.R. Korçë "Deklaratën e Konfidencialitetit", por nuk e ka aplikuar për të gjithë punëmarrësit/mësuesit/psikologët të cilët aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në varësi të D.A.R. Korçë. Nga verifikimi i kryer pranë Zyrës Arsimore Vendore Pogradec u konstatua se nuk aplikohet Deklarata e Konfidencialitetit për punëmarrësit e Z.A.V. Pogradec dhe mësuesit/psikologët e shkollave;

3. Konstatohet se në kartelat/dosjet personale të punëmarrësve ndodhen të dhëna dhe përshkrime në një afat mbi 30-vjeçar, të cilat kanë të bëjnë me opinione dhe përshkrime ideologjike për subjektin e të dhënave.
4. Konstatohet publikimi të dhënave personale të maturantëve në ambiente publike të gjimnazit "Gjergj Pekmezi" Pogradec. Të dhënat konsistojnë në publikimin e emrave të nxënësve si dhe numrit unik të identifikimit në provimet e maturës.
5. Konstatohet se dosjet personale të krijuara nga psikologët e gjimnazeve ruhen për një periudhë 5-vjeçare nga shkëputja e subjektit të të dhënave "nxënës", sipas ligjit të arkivave por kjo gjë nuk është e përcaktuar në rregulloret apo udhëzimet e brendshme.
6. Konstatohet se në portalin e kontrolluesit [www.darkorce.arsimi.gov.al](http://www.darkorce.arsimi.gov.al), <http://darkorce.arsimi.gov.al/index.php/za-devoll> etj., janë publikuar rezultatet e testimit të mësuesve. Në një prej tabelave publike, ndodhet lista përfundimtare e portalit për pikët e testimit të mësuesve. ID-ja e testimit, pikët, nr. personal i ID-së unike e subjektit të të dhënave, lënda etj.

**Faktet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 21, 22, dhe 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03. 2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.**

**Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Rregullore e brendshme e funksionimit të D.A.R. Korçë;
- Rregullore e etikës administrative të D.A.R. Korçë;
- Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Deklaratë konfidencialiteti;
- Rregullore e TIK;
- Manual i përdoruesit (mësuesit);
- Manual i mbikëqyrësit;
- Dosje e një punonjësi e cila daton nga viti 1990;
- Printim nga portali [www.darkorçe.arsimi.gov.al](http://www.darkorçe.arsimi.gov.al) i tabelës së të dhënave të mësuesve që kanë aplikuar në portalin "Mësues për Shqipërinë";
- Udhëzime dhe manuale për psikologët e shkollave;
- Praktikë e psikologut të shkollave në lidhje me Personat me Afërsi të Kufizuara.
- Fotografi të ambienteve në të cilat janë publikuar të dhënat e maturantëve;

Në zbatim të kërkesave të Urdhrit Nr.148 të Komisionerit, në datë 21.06.2016 e vazhdim u krye hetimi administrativ pranë administratës së D.A.R. Korçë, Zyra Arsimore Vendore Pogradec dhe tre shkollave të dy qyteteve: Gjimnazi "Themistokli Gërmenji", shkollat 9-vjeçare "Demokracia" Korçë, dhe gjimnazit "Gjergj Pekmezi", Pogradec.

Sikurse konstatohet në proces verbal, detyrimin për njoftim kontrolluesi nuk e kishte përmbushur, por në datë 22.06.2016, me Nr.699 prot, DAR Korçë ka depozituar Formularin e Njoftimit, pranë Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi DAR Korçë, efektin e Deklaratës së Konfidencialitetit e kishte të kufizuar vetëm brenda administratës së saj. Personeli i ZAV Pogradec, si dhe shkollat e kontrolluara në dy

qytetet, nuk aplikonin Deklaratat e Konfidencialitetit për punëmarrësit që aksesonin të dhënat personale.

Në lidhje me shërbimin psikosocial që ofrohet në shkollat 9-vjeçare dhe ato të mesme, psikologët dhe punonjësit e shërbimit social, të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhëna sensitive të nxënësve vulnerabël, të nxënësve me probleme sociale, apo nxënësve problematikë në komunitet, nuk aplikonin Deklaratë Konfidencialiteti. Rregulloret e mbrojtjes së të dhënave personale që u paraqitën nga D.A.R Korçë dhe Z.A.V. Pogradec, mbeten fiktive, pasi ato nuk kishin efekte konkrete për shkollat të cilat janë strukturat kryesore dhe potenciale në përpunimin e të dhënave personale.

Në përgjithësi dhe nga praktikat e mëparshme personeli mësimdhënës dhe ai psikosocial, shprehen se fëmijët vulnerabël në shumicën e rasteve dallohen prej komunitetit nga karakteristikat e fytyrës dhe sjelljes, por kjo nuk do të thotë që të dhënat e tjera të mbledhura në dosje manuale, të mos jenë të siguruara.

Në dosjet e vjetra të punëmarrësve, konstatohen të dhëna mbi mendimet politike të tyre, kur Udhëzimi i MAS-it Nr.12 datë 27.04.2015, paragrafi 6, gërma "c", shprehet:

*"Ndër të dhënat personale të subjekteve, nuk përfshihen këto të dhëna për ta dhe prindërit/fëmijët e tyre: Origjina racore, origjina etnike, mendimet politike, anëtarësimi...etj".*

Në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, por veçanërisht dhe në mbështetje të Udhëzimit të MAS-it Nr.12, datë 27.04.2015 *"Për mbledhjen përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale"*, duhej të ishin marrë masat e duhura, ato më kryesoret që krijojnë një lloj sigurie dhe ecurie fillestare në mbrojtjen e të dhënave:

1-Formulari i Njoftimit, i cili nuk përmendet në këtë udhëzim, për faktin se ky formular konsiderohet të jetë kryer kohë para se të dilte akti nënligjor në fjalë.

2- Deklarata e Konfidencialitetit, (paragrafi 14, gërma "b"), jo vetëm për një proces pune apo një strukturë, por në tërësi dhe vazhdimësi për gjithë aktivitetin e punëmarrësve të DAR Korçë, që aksesojnë të dhëna personale.

Në paragrafin 18 të po këtij udhëzimi, i cili duhej të ishte zbatuar rigorozisht, parashikohet, *"Transmetimi dhe arkivimi i dosjeve të të dhënave"*, mënyra e transmetimit të dosjeve, *"Kur një subjekt i një institucioni arsimor transferohet në një institucion tjetër, drejtori i institucionit i dorëzon me procesverbal drejtorit të institucionit pritës dosjen personale përkatëse"*.

Mungesa e këtij transmetimi u konstatua me dosjet e nxënësve me aftësi të kufizuara, të cilat ruheshin nga psikologët sipas vlerësimit të tyre, pasi që nuk kishin një bazë ligjore për afatin e ruajtjes, por edhe nuk kishin dijeni për këtë udhëzim.

Shumica e institucioneve të DAR-ve në vend, në strukturën e tyre kanë dhe shkollat speciale, të cilat trajtojnë fëmijët me aftësi të kufizuara. Gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ në fushën e arsimit, grupi i kontrollit nuk konstatoi një rregullore të veçantë apo dhe klauzola brenda rregulloreve funksionale për mënyrën se si administrohen, kohën dhe mënyrën se si ruhen, transmetimin apo përhapjen e të dhënave sensitive të kësaj kategorie.

Në përfundim të kontrollit administrativ u hartua procesverbali, i cili u lexua në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit. Përfaqësuesit e kontrolluesit u shprehën se do të përmbushin konstatimet e shprehura në proces verbal dhe do i paraqesin ato para seancës dëgjimore. Pretendime nuk u paraqitën.

Administrata e kontrolluesit D.A.R. Korçë, Z.A.V. Pogradec, si dhe shkollat në varësi të këtyre institucioneve, ishin të impenjuar në disponibilitetin dhe seriozitetin për bashkëpunim me grupin e inspektimit.

Në zbatim të neneve 87 - 89 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", datë 30.04.2015, në datë 19.07.2016, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ.

Në seancë dëgjimore përfaqësuesi i kontrolluesit, nuk u paraqit për të shprehur pretendimet e tij. Në datë 20.07.2016, shërbimi postar dorëzon në protokollin e Zyrës së Komisionerit shkresën me Nr.696 Prot., datë 18.07.2016, me lëndë kërkesën, për shtyrje të seancës dëgjimore për arsye se: *"..personeli i autorizuar për çështjen nga ana jonë, po kryen lejën e zakonshme"*.

Zyra e Komisionerit çmon se, Kodi i Procedurave Administrative të Shqipërisë, parashikon hapësira për palët në një proces administrativ, dhe konkretisht neni 88, rezervon *të drejtën e palës për t'u dëgjuar në çdo formë të përshtatshme dhe brenda afatit*. Krahas shkresës Nr.696 Prot., datë 18.07.2016 me lëndë, kërkesën për shtyrje të seancës dëgjimore, D.A.R. Korçë mund të kishte përcjellë pranë Zyrës së Komisionerit masat e marra në përmbushjen e detyrimeve që dalin nga proces verbali i grupit të kontrollit.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërma "dh" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, janë serioze për vetë faktin e përmasës së kontrolluesit, gamës së të dhënave sensitive që ky kontrollues mbledh e përpunon. Si të tilla këto shkelje përbëjnë *"kundërvajtje administrative"*, dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

*-dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë."*

Kontrolluesi D.A.R. Korçë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, kryesisht për kategoritë *"nxënës"* dhe *"mësues"*.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 28, 39 paragrafi 1, gërma "dh", si dhe nenit 39, paragrafi 2 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit *Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë*, me gjobë në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
2. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë*, të realizojë për Zyrat Arsimore të cilat janë në varësi të tij, pajisjen e kontratave të punëmarrësve me Deklaratat e Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013, të Komisionerit, si dhe të shtrijë efektet e rregullores së formalizuar për mbrojtjen e të dhënave personale pranë tyre, brenda një periudhe 3 mujore.
3. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë*, në përputhje me në përputhje me Udhëzimin Nr.4, datë 16.03.2010 të Komisionerit "*Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit*", paragrafet 3 dhe 4, si dhe në përputhje me kushtet në të cilat ushtron detyrat, të përcaktojnë afatet e mbajtjes të të dhënave personale sensitive, për nxënësit me probleme sociale, nxënësit me probleme të shëndetit mendor, dhe nxënësit problematikë në sjellje.
4. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë*, në përputhje me Udhëzimin Nr.12, datë 27.04.2015, paragrafi 6, gërma "c", të marrë masat në zbatimin e këtij paragrafi, për të mos ruajtur të dhëna të tepërta sensitive.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi.  
  
Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 29.07.2016

**Besnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**  
